

Pozita	Zyrtar i Shërbimit për Anëtarë
Nr. i referencës	IKAF-09
Lloji i Kontratës	Kontratë e rregullt
Raporton	Drejtorit Ekzekutiv
Departamenti/Komisioni	Departamenti për administrate dhe financa
Forma e angazhimit	Me orar të plotë
Nr. i pozitive	1
Vendi:	Prishtinë

Instituti KAF është i përkushtuar në ndërtimin e profesionit të kontabilistëve dhe auditorëve në bazë të parimeve të larta Profesionale Etike, Standardeve Ndërkombëtare, sipas Rregulloreve të Ligjit në fuqi dhe sipas plan-programit të harmonizuar me ACCA dhe IIA Global.

Detyrat e Zyrtarit për Shërbimin me Anëtarë:

- a) Përkrah anëtarët e IKAF lidhur me zhvillimin e tyre profesional dhe mbarëvajtjen e procesit certifikues;
- b) Parashtron kërkesat dhe nevojat e anëtarëve tek Menaxhmenti dhe Komisionet përkatëse;
- c) Monitoron avancimin e anëtarëve në IKAF përmes komunikimit të vazhdueshëm, duke iu referuar Edukimit të Vazhdueshëm Profesional , pajtueshmërinë me kërkesat e IKAF etj;
- d) Monitoron anëtarët duke iu referuar numrit te tyre, interesimeve, sektorëve ku janë të punësuar dhe kriterëve tjera të cilat mund të ndikojnë në IKAF për rritjen e mundësive për t’i shërbyer më mirë;
- e) Zhvillon metoda (on-line, informatorë për trajnime dhe vlerësime) që do t’i ndihmojnë anëtarët me këshilla teknike në punën e tyre si dhe bën hulumtime të ndryshme me qëllim të përmirësimit të shërbimeve ndaj anëtarëve;

Kushtet e nevojshme:

Për titullin **Zyrtarë i Shërbimit për Anëtarë**, kandidati duhet të dëshmojë dokumentacionin si më poshtë:

1. Dëshmon kualifikimin akademik dhe profesional
2. Dëshmon nivel të lartë dhe kompetencë profesionale që dëshmohet me:
 - a) Të ketë të përfunduar Nivelin Bachelor;
 - b) Të ketë së paku dy (2) vite eksperiencë në ndonjë institucion edukativ (e preferueshme)
 - c) Aftësi shumë të mira analitike dhe transmetuese.